



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 432/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Ferizaj, paraqitur kundër Koalicionit për Kosovën e Re, me seli në Ferizaj, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Koalicionit për Kosovën e Re, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 4200 (katërmijedyqindeuro) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Më datë 11.12.2010 PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK, në të cilën pretendohet se anëtarët e koalicionit politik Kosova e Re më datë 10.12.2010 në orën 14:30 në rrugën “Deshmoret e Kombit” në Ferizaj, gjatë fushatës zgjedhore kanë vënë posterat e tyre mbi posterat e PDK, që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi, në të cilën shihen qartë se posterat e kandidatëve për Kuvend të Republikës së Kosovës nga radhët e Koalicionit për Kosovën e Re janë vendosur mbi posterat e Ilmi Reqicës kandidatit nga radhët e PDK-ës. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi Koalicionin për Kosovën e Re, më datë 12.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 13.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, pranoi përgjigje në ankesë nga Koalicioni për Kosovën e Re, sipas afatit të caktuar në të cilën theksohet se ankesa në fjalë është në kundërshtim të plotë me provat e paraqitura. Më tej në përgjigje theksohet se “nëse shikohen me kujdes provat-fotot nga ato asgjë nuk mund të konstatohet apo të vërtetohet se kush ja ka mbuluar kujt posterat, pasi që të gjitha posterat janë të dëmtuara dhe të vendosura kryesisht mbi posterat e AKR, e më së paku të vendosura mbi posterat e ankuesit. Prandaj është e papranushme një gjë e tillë pasi

që dëmtimin e posterave ka mundur ta bëjë çdokush me qëllime të ndryshme politike apo komerciale. Andejme konsiderojme se ankesa është e pabazë”.

Përgjigjes në ankesë Koalicioni për Kosovën e Re nuk i ka bashkangjitur asnjë provë që tregon se ky subjekt politik ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar shkeljen e këtij Kodi.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Neni 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- **ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se koalicioni për Kosovën e Re ka mbuluar posterat e PDK-se. Gjithashtu PZAP vlerëson se koalicioni për Kosovën e Re, shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur edhe më parë, rrjedhimisht konsiderohet si recivist, rrethanë e

cila ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar më gjatë. Prandaj nga arsyet e lartcekura dhe në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 432/2010 më datën 13.12.2010

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**

